



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

Nr. 2836 Prot

Kukës, 07. 06.2024

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Tema e konsultimit:

Projektvendim

“Për dhënien pëlqimi në parim për dhënien me qira të pasurisë Nr. 155/1, të llojit pyll (cungishte), pjesë të saj, përkatësisht sipërfaqen 0,5 HA dhe 0.2 km rrugë, pjesë e pasurisë në fshtin DrinasNjësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës. Fusha e përdorimit të pronës që jepet me qira të jetë : “Për qëllime pushimi, argëtimi (kënde lojrash, shlodhëse etj)

Propozuesi i konsultimit:

Këshilli Bashkiak

Informacion për konsultimin:

Nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, me datë 04.06.2024, është sjellë për shqyrtim propozimi për miratimin në parim të dhënies me qira me anë të konkurimit me afat 5 vjeçar me të drejtë rinovimi, të sipërfaqes prej 0,5 HA dhe 0,2 km rrugë lidhëse të llojit pyll (cungishte), pjesë e pasurisë 155/1, ngastra 7/c, ekonomia pyjore Mamëz-Kalimash, fshati Drinas.

Përpara shqyrtimit të këtij projektvendimi, Këshilli Bashkiak organizon takimin me banorët e Njësisë Administrative Kolsh (fshati Mamëz), të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke dhënë mendimet, rekomandimet e sugjerimet e tyre.

Vendi, koha e konsultimit:

Konsultimi do të organizohet ditën e enjte, me datë 27.06.2024, ora 10⁰⁰, në lagjen Drinas.

Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

Nga organizatorët:

Kryetari/Anëtarët e Këshillit Bashkiak/Sekretari i Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisw/ Përfaqësues nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.

Nga të ftuarit:

Banorë të fshatit Mamëz, Kryetarë e Anëtarë të Kryesisë së fshatit, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

Forma e konsultimit:

Marrja e opinioneve dhe mendimeve nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në mbledhjet e komisionit përkatës dhe mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Me respekt,

Kryetari i Këshillit
Albert MUJA

